	<b>RREGULLORJA PËR FUNKSIONIMIN DHE ORGANIZIMIN E NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË</b>				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
BU-REG-030-AL	24.10.2014	1		1 / 11	

## Neni 1

### Baza ligjore e rregullores

Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë (më poshtë “Rregullorja”) e Kolegjit Universitar “Bedër” mbështetet në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin e institucionit si dhe në dispozitat e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë.

## Neni 2

### Qëllimi

Kjo rregullore parashikon funksionimin e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si edhe synon rregullimin e procesit të vlerësimit të arsimimit, mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe çdo shërbimi në Kolegjin Universitar “Bedër”, si zhvillimin e cilësisë, ngritjen e sistemit të kontrollit të brendshëm, aplikimin, zhvillimin dhe vlerësimin e tij, miratimin e treguesve të cilësisë në kuadër të periudhës së “vlerësimit të jashtëm”.

## Neni 3

### Fusha e zbatimit


Kjo rregullore rregullon organizimin dhe administrimin e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë i cili është organi përgjegjës për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, për monitorimin dhe koordinimin e veprimtarive të ndërmarra në kuadër të vlerësimit akademik dhe administrativ, për përmirësimin e cilësisë nëpërmjet raporteve të vlerësimit, kontrollin periodik dhe ndjekjen së tyre në institucion.

## Neni 4

### Parime ku do të mbështetet puna e NJSBC

Përgjatë veprimtarisë së saj Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë do të mbështetet në parimet bazë të mëposhtme:

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë	Senati

	<b>RREGULLORJA PËR FUNKSIONIMIN DHE ORGANIZIMIN E NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË</b>				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-030-AL	24.10.2014	1		2 / 11

## **Gjithë përfshirja**

Proceset e sigurimit të cilësisë do të zbatohen për të gjitha dispozitat e Kolegjit Universitar në procesin e mësimnxënies dhe mësimdhënies ashtu dhe në programet e bashkëpunimit me institucionet e tjera. Përvoja të mësuarit e të gjithë studentëve do të vlerësohet në mënyrë sistematike duke reflektuar rregullisht dhe në mënyrë periodike për të përmirësuar këto procese.

## **Koherenca**

Komponentët e Kornizës së Cilësisë do të ndërlidhen dhe do të veprojnë për të rishikuar në mënyrë koherente dhe tërësore informacionet dhe stafin/ studentët prej të cilëve është marrë ky informacion.

## **Objektiviteti**

Proceset e vlerësimit të cilësisë të institucionit udhëhiqen nga këndvështrimi dhe kontributi i ekspertëve dhe organizmave të institucionit. Kolegji Universitar i nënshtrohet procesit fillestar dhe periodik të akreditimit të kryer nga bashkëpunimi i punës së stafit akademik, studentëve dhe ekspertëve të jashtëm.

## **Efikasiteti dhe përmirësimi**


Komponentët e Kornizës së Cilësisë akademik do të dizajnohen për të analizuar në mënyrë rigoroz standardet akademike dhe rritjen e cilësisë akademike, duke përmbushur nevojat e stafit akademik dhe duke minimizuar ndikimin që mund të ketë kjo analizë në ngarkesën e punës. Për këtë arsye proceset e vlerësimit do të jenë periodike, kryesisht vjetore nga ana e NJSBC-së.

## **Përgjegjësi të transferuara**

Stafi i Kolegjit Universitar është kolektivisht përgjegjës për ruajtjen e standardeve akademike. Komponentët e Kornizës Akademik të cilësisë do të jenë të dizajnuara për të mbështetur dhe transferuar përgjegjësinë tek i gjithë stafi i përfshirë në veprimtarinë akademike si dhe për të treguar se ne jemi të përkushtuar për të ofruar një përvojë të mësuarit me cilësi të lartë.

Njësia e Sigurimit të cilësisë ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë	Senati

	<b>RREGULLORJA PËR FUNKSIONIMIN DHE ORGANIZIMIN E NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË</b>				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-030-AL	24.10.2014	1		3 / 11

## Neni 5

### Përkufizime

**Kolegji Universitar; KUB:** Kolegji Universitar “Bedër”;

**Njësitë akademike:** Fakultetet, departamentet, si edhe qendrat kërkimore-zhvillimore në KUB;

**Komisioni i përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit:** Organi kolegjalë, që kryen funksione në fushat e përcaktuara në statut, që lidhen kryesisht me garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit, me mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij dhe marrëdhëniet me studentët, në përputhje me misionin dhe politikat e institucionit;

**Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e Kolegjit Universitar “Bedër” (NJSBC):** Njësia është përgjegjës për monitorimin dhe koordinimin e veprimtarive të ndërmarra në kuadër të menaxhimit dhe vlerësimit akademik dhe administrativ, përmirësimin e cilësisë, planifikimin strategjik, vlerësimin institucional, vlerësimin e jashtëm, kontrollin periodik, si edhe ndjekjen e përmirësimit të cilësisë në Kolegjit Universitar “Bedër”.

**Misioni:** Misioni i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) është vlerësimi periodik i efikasitetit të veprimtarive mësimore, kërkimore-zhvillimore, si edhe të veprimtarive administrative dhe financiare të institucionit.

**Vizioni:** Objektivat që synohen të arrihen nga njësitë akademike dhe administrative të Kolegjit Universitar “Bedër”.


**Aktivitete dhe projekte:** Aktivitetet dhe projektet e parashikuara në buxhet ose të panevojshme për t’u parashikuar në buxhet, të matshme nëpërmjet treguesve të performacës, në kuadër të realizimit të synimeve të përfshira në qëllimet strategjike të Kolegjit Universitar “Bedër”.

**Plani i zbatimit:** Planet të cilat përcaktojnë periudhat e nevojshme, përgjegjësitë dhe afatet e realizimit të aktiviteteve dhe projekteve të institucionit, njësive akademike ose administrative, në përputhje me qëllimet dhe strategjitë e Kolegjit Universitar “Bedër”.

**Monitorimi:** Punimet mbi matjen e suksesit dhe vlerësimin e masave të ndërmarra në kuadër të strategjive të përmirësimit dhe zhvillimit të njësive akademike dhe administrative të Kolegjit Universitar “Bedër”.

**Përmirësimi:** Objektivat e përcaktuar nga ana e Kolegjit Universitar “Bedër”, si edhe

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë	Senati

	<b>RREGULLORJA PËR FUNKSIONIMIN DHE ORGANIZIMIN E NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË</b>				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-030-AL	24.10.2014	1		4 / 11

veprimtaritë e kryera për përmbushjen e këtyre objektivave, si dhe veprimtaritë e kryera për pakësimin e mospërputhjeve ndërmjet aksioneve të kryera dhe rezultateve të arritura.

**Përmirësimi i planit të veprimit:** Plani i cili parashikon përmirësimet që do të bëhen, përgjegjësitë për realizimin e tyre dhe afatet, bazuar në përfundimet e procesit të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të Kolegjit Universitar “Bedër”.

**Vlerësimi i brendshëm:** Vlerësimi periodik i rezultateve të cilësisë së arsimimit, kërkimit, burimeve njerëzore, financave, infrastrukturës, marrëdhënieve me publikun, marrëdhënieve ndërkombëtare, aktiviteteve sociale dhe kulturore, punimeve në kuadër të zhvillimit të cilësisë dhe aktiviteteve përmirësuese.

**Vetëvlerësimi:** Procesi i vlerësimit gjithëpërfshirës, sistematik dhe i rregullt, i kryer nga persona të caktuar nga drejtuesit e Kolegjit Universitar “Bedër”, mbi arsimimin, kërkimin, burimet njerëzore, financat, infrastruktura, marrëdhëniet me publikun, marrëdhëniet ndërkombëtare, aktivitetet sociale dhe kulturore si dhe punimet në kuadër të zhvillimit të cilësisë dhe aktiviteteve përmirësuese.

**Vlerësimi i jashtëm:** Vlerësimi i jashtëm, nga një institucion i pavarur kombëtar ose ndërkombëtar i aspekteve të tilla të cilësisë, si: arsimimi, kërkimi, burimet njerëzore, financat, infrastruktura, marrëdhëniet me publikun, marrëdhëniet ndërkombëtare, aktivitetet sociale dhe kulturore.


**Grupet e vlerësimit:** Grupi i caktuar me qëllim kryerjen e përgatitjes së vlerësimit institucional të Kolegjit Universitar “Bedër”.

**Vlerësuesit e jashtëm:** Institucioni, organizata ose këshillat, të cilët kryejnë veprimtarinë e tyre brenda ose jashtë vendit dhe mundësojnë pajisjen me “Certifikatat e vlerësimit të cilësisë”.

**Komisionet ad-hoc:** Komisione të cilat, në bashkëpunim dhe në funksion të NJSBC, japin rekomandime dhe kontribut në fushat për të cilat nevojiten njohuri të veçanta teknike, duke vendosur marrëdhënie me njësitë akademike dhe administrative, gjatë procesit të vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë, planifikimit strategjik, vlerësimit institucional, vlerësimit të jashtëm, përmirësimit periodik dhe auditimit të arsimimit, kërkimit, burimeve njerëzore, financat, infrastruktura, marrëdhëniet me publikun, marrëdhëniet ndërkombëtare, aktivitetet sociale dhe kulturore.

**Analiza “SWOT”:** Analiza e cila pasqyron anët e forta, të dobëta, si edhe mundësitë dhe rreziqet për institucionin.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë	Senati

	<b>RREGULLORJA PËR FUNKSIONIMIN DHE ORGANIZIMIN E NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË</b>				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-030-AL	24.10.2014	1		5 / 11

**Raporti vjetor i vlerësimit:** Raporti vjetor i cili paraqet rezultatet e vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë në institucion.

## Neni 6

### Përbërja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 1 (një) kryetar, 2 (dy) janë përfaqësues të personelit akademik të njësisë kryesore një për çdo fakultet, 1 (një) përfaqësues i Këshillit Studentor dhe 1 (një) ekspert i jashtëm. Anëtarët e njësisë miratohen nga Senati Akademik me propozim të rektorit.

Autoritetet drejtuese të Kolegjit Universitar “Bedër”, si rektori, dekanët dhe administratori nuk mund të jenë anëtarë të NJSBC-së.

## Neni 6/1

### Relatori i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

*(Shtuar me vendim senati nr.5 datë 08.01.2020)*

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka një relator, i cili caktohet me shumicën e votave të gjithë anëtarëve të këtij organi kolegjal. Relatori duhet të jetë një nga anëtarët e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili vetëkandidohet ose propozohet nga anëtarët e tjerë.

Relatori merr pjesë në të gjitha mbledhjet e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë duke mbajtur proces-verbalin përkatës.


Përgatit kushtet për mbarëvajtjen e të gjitha mbledhjeve të njësisë: njoftimet, sallën e mbledhjeve, materialet e mbledhjeve, etj.

Mban dhe nënshkruan procesverbalin e mbledhjeve si dhe zbardh vendimet e marra, jo me vonë se 5 ditë nga përfundimi i mbledhjes. Relatori kryen dhe detyra të tjera të caktuara nga kryetari.

Në rast mungese të tij, për arsye objektive për një mbledhje të njoftuar, relatori zëvendësohet, nga një anëtar tjetër i caktuar prej Kryetarit.

## Neni 7

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë	Senati

	<b>RREGULLORJA PËR FUNKSIONIMIN DHE ORGANIZIMIN E NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË</b>				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-030-AL	24.10.2014	1		6 / 11

## **Kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve**

Çdo dy vjet Senati i Kolegjit Universitar “Bedër” përcakton anëtarët e NJSBC.

### **Neni 8**

#### **Vendimmarrja**

Mbledhja e NJSBC quhet e vlefshme, në rast se në të marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë të gjithë anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje. Në rast barazimi, vota e kryetarit të mbledhjes është vendimtare.

### **Neni 9**

#### **Afatet e mbledhjes**

*(Ndryshuar me vendim Senati 01.07.2020)*

NJSBC mbledhet në mbledhje të zakonshme të paktën 4 (katër) herë në vit. Në raste të nevojshme, kryetari mund të thërrasë mbledhjen e jashtëzakonshme. Por, duke siguruar edhe pjesëmarrjen e personave të interesuar, ai thërret mbledhjen e zgjeruar.

### **Neni 10**

#### **Asistentët e departamenteve**


*(Shtuar me vendim Senati 01.07.2020)*

Çdo departament cakton një asistent me vendim të Këshillit të Departamentit pranë NJSBC me qëllim që të ofrojnë asistencën e tyre në mbarëvajtjen e veprimtarisë së NJSBC.

Asistenti i departamentit koordinon punët në departament lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë, ai ushtron detyrën e tij në bashkëpunim me njësitë e tjera nën varësinë e NJSBC”. Ai drejton dhe koordinon punën e tij, njofton departamentin përkatës për vendimet e marra, mbikëqyr zbatimin e procesit të punës në kuadrin e sigurimit të cilësisë dhe monitoron rezultatet e kësaj pune si dhe informon NJSBC për mbarëvajtjen e punëve në departamentin gjegjës.

### **Neni 11**

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë	Senati

	<b>RREGULLORJA PËR FUNKSIONIMIN DHE ORGANIZIMIN E NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË</b>				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-030-AL	24.10.2014	1		7 / 11

## Detyrat dhe Kompetencat e NJSBC

Kompetencat e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë:

Të mbështesë Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë Institucionale të hartojë politikat dhe procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë, akte të cilat miratohen nga Senati Akademik.

Të mbështesë Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë Institucionale të për të hartuar standardet për sigurimin e cilësisë, në përputhje me Kodin e Cilësisë.

Të vlerësojë, në mënyrë periodike, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore në njësitë kryesore të Kolegjit, në përputhje me standardet.

Të kryejë studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga Kolegji, në bashkëpunim me njësitë përkatëse.

Të hulumtojë në lidhje me modelet e ndryshme, në kuadër të përmirësimit të cilësisë, që mund të merren si shembull, si edhe shpërndarjen e tyre në njësitë e tjera akademike dhe administrative.

Koordinimin e zbatimit të standardeve të kontrollit të brendshëm, në përputhje me kuadrin rregullator të Kolegjit Universitar “Bedër”, përgatitjen e planit të veprimit të kontrollit të brendshëm, si edhe, në raste të nevojshme, përcaktimin e standardeve të reja në institucion.

Të rekomandojë qëllime dhe strategji institucionale.

Propozime mbi zbatimin e planit strategjik të institucionit dhe planin e veprimit.


Propozimin e aktiviteteve për përmirësimin dhe monitorimin periodik në të gjithë institucionin.

Përgatitjen e rekomandimeve shtesë në udhëzuesit e NJSBC mbi përmirësimin e cilësisë dhe planifikimin strategjik të njësive akademike dhe administrative.

Vlerëson dhe publikon të gjitha veprimtaritë e përgatitura në njësi mbi vlerësimin e shërbimeve akademike dhe administrative, zhvillimin e cilësisë dhe miratimin e standardeve të cilësisë;

Administron procesin e planifikimit strategjik në njësi të miratuar nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë Institucionale dhe përshtatjen me ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe aktet e tjera nënligjore. Në kuadrin e planit dhe

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë	Senati

	<b>RREGULLORJA PËR FUNKSIONIMIN DHE ORGANIZIMIN E NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË</b>				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-030-AL	24.10.2014	1		8 / 11

qëllimevstrategjike kryen vlerësimin e shërbimeve administrative, zhvillimin e cilësisë, miraton standardet e cilësisë, si dhe kryen çdo detyrë tjetër në këtë kuadër dhe publikon rezultatet.

Njofton njësitë për vendimet e marra, mbikëqyr zbatimin e procesit të punës në kuadrin e sigurimit të cilësisë dhe monitoron rezultatet e kësaj pune.

Ndjek procesin e vlerësimit të brendshëm të institucionit, si dhe mbikëqyrjen e përgatitjes së raportit të vetëvlerësimit.

Ndjek përgatitjen e terrenit për “vlerësimin e jashtëm” të Kolegjit Universitar “Bedër” dhe vënien në dispozicion të institucionit ose organizatës së vlerësimit të jashtëm të çdo informacioni të nevojshëm.

Ndjek nga afër punimet e vlerësimit të brendshëm dhe të atij institucional dhe i koordinon me masat e ndërmarra në kuadër të planifikimit strategjik, përmirësimit dhe monitorimit periodik.

Jep sugjerime duke u bazuar në problemet e evidentuara nga analiza “SWOT”.

Në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve, ajo organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në bashkëpunim me sekretarinë mësimore.

Pas çdo vlerësimi raporton para Senatit Akademik rezultatet dhe propozimet përkatëse.

## Neni 12

### Komisionet Ad Hoc


#### Formimi i komisionit dhe kryetari

NJSBC, në raste të nevojshme dhe për fusha në të cilat nevojitet një ekspertizë e veçantë, vendos krijimin e komisioneve ad-hoc. Çdo komision përbëhet nga e shumta pesë anëtarë. Kryetari i komisionit zgjidhet mes anëtarëve të tij. Komisioni, në rast se e gjykon të arsyeshme, mund të kërkojë mendimin e personave të tretë, sipas fushës së tyre të ekspertizës ose mund t’i caktojë ato si anëtarë të komisionit.

Komisionet ad-hoc kanë një mandat të përcaktuar në momentin e krijimit të tyre, në bashkëpunim dhe ndihmë të NJSBC dhe komisionit të përhershëm, japin rekomandime

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë	Senati



	<b>RREGULLORJA PËR FUNKSIONIMIN DHE ORGANIZIMIN E NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË</b>				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-030-AL	24.10.2014	1		9 / 11

dhe kontribut në fusha për të cilat nevojiten njohuri të veçanta teknike, duke vendosur marrëdhënie me njësitë akademike dhe administrative, gjatë procesit të vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë, planifikimit strategjik, vlerësimit institucional, vlerësimit të jashtëm, përmirësimit periodik dhe auditimit të arsimit, kërkimit, burimeve njerëzore, financave, infrastrukturës, marrëdhënieve me publikun, marrëdhënieve ndërkombëtare, aktiviteteve sociale dhe kulturore.

### **Neni 13**

#### **Punimet rreth sistemit të kontrollit të brendshëm dhe kalendari**

Standardet përcaktohen në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe të Bashkimit Europian dhe zbatimi i tyre pasqyrohet në planet e veprimit të Kolegjit Universitar “Bedër” dhe të të gjitha njësive. Aktivitetet që do të zbatohen në kuadër të aplikimit të standardeve të kontrollit të brendshëm, do të përgatiten në mënyrë periodike dhe do të parashikohen në planin e veprimit të kontrollit të brendshëm. Planet e veprimit për vitin pasardhës përgatiten në muajin dhjetor të vitit paraardhës. Zbatimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe i monitorimit dhe vlerësimit, pasqyrohen në raportet e kontrollit të brendshëm. Afati i dorëzimit të raporteve përcaktohet me vendim të NJSBC-së.

### **Neni 14**

#### **Periudha dhe kalendari i vlerësimit të brendshëm**


Kryhen të gjitha punimet e “Vlerësimit të brendshëm” në të gjitha njësitë, në bazë të modelit dhe rregullave të vlerësimit të brendshëm të përcaktuara në udhëzuesin mbi vlerësimin dhe zhvillimin e cilësisë. Raportet e vlerësimit të brendshëm të njësive dhe raporti i vlerësimit të brendshëm të Kolegjit Universitar “Bedër” përgatiten çdo vit brenda afateve ligjore.

### **Neni 15**

#### **Periudha dhe kalendari i planit të veprimit të përmirësimit**

Me qëllim përmirësimin e problemeve të evidentuara gjatë vlerësimit të brendshëm dhe

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë	Senati

	<b>RREGULLORJA PËR FUNKSIONIMIN DHE ORGANIZIMIN E NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË</b>				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
BU-REG-030-AL	24.10.2014	1		10 / 11	

të jashtëm, njësitë përgatisin planet e veprimit të përmirësimit. Në këto plane përcaktohen përmirësimet që duhet të realizohen, përgjegjësitë për realizimin e tyre, caktohen afatet dhe burimet për realizimin e tyre.

Planet e veprimit të përmirësimit menaxhohen nga drejtuesi i njësisë. Planet e veprimit të përmirësimit kryhen pasi të jenë shqyrtuar rekomandimet e komisionit të vlerësimit dhe zhvillimit të cilësisë së njësive. Njësitë dorëzojnë në NJSBC planet e veprimit të përmirësimit, në të cilat pasqyrohen rezultatet e vlerësimit, në afatet e përcaktuara nga NJSBC.

## **Neni 16**

### **Periudha dhe kalendari i vlerësimit të jashtëm**

Kolegjit Universitar “Bedër” mund të aplikojë për pajisje me Certifikatën e Regjistrimit të Vlerësimit të Cilësisë, me qëllim vlerësimin në tërësi të Kolegjit Universitar “Bedër” ose të një ose më shumë njësive, në aspekte të tilla, si procesi i vetëvlerësimit, menaxhimit, arsimimit, kërkimit dhe cilësia e shërbimeve administrative. Në vitin, gjatë të cilit kryhet vlerësimi i jashtëm, nuk kryhet vlerësim i brendshëm.

## **Neni 17**

### **Miratimi i cilësisë dhe periudha e vlefshmërisë**


Në përfundim të vlerësimit të jashtëm, Kolegjit Universitar “Bedër” ose njësia pajiset me certifikatën e cilësisë, e cila pasqyron cilësinë dhe nivelin e zhvillimit të cilësisë. Kjo certifikatë mund të merret edhe nga një ose më shumë njësi akademike, nga një ose më shumë programe të njësive akademike ose nga një ose më shumë njësi administrative.

## **Neni 18**

### **Publikimi i rezultateve të vlerësimit**

Publikimi i rezultateve të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të Kolegjit Universitar “Bedër” është i detyrueshëm. Raportet vjetore të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë	Senati

	<b>RREGULLORJA PËR FUNKSIONIMIN DHE ORGANIZIMIN E NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË</b>				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-030-AL	24.10.2014	1		11 / 11

Kolegjit Universitar “Bedër” dhe raporti i komisionit të vlerësimit dhe zhvillimit të cilësisë në arsimin e lartë publikohen në faqen e internetit.

### **Neni 19**

#### **Çmimet për zbatim të mire**

NJSBC, me qëllim rritjen e motivimit, i propozon rektoratit të Kolegjit Universitar “Bedër”, dhënien e çmimeve për njësitë akademike dhe administrative për detyrat e kryera në kuadër të kësaj rregulloreje.

### **Neni 20**

#### **Shpenzimet për punimet në fushën e cilësisë**

Kolegjit Universitar “Bedër”, duke paguar nga buxheti i tij, në kuadrin e detyrave të caktuara nga kjo rregullore, mund të kërkojë marrjen e shërbimeve nga persona të tretë.

### **Neni 21**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga senati akademik i Kolegjit Universitar “Bedër”.

### **Neni 22**

#### **Zbatimi**

Zbatimi i kësaj rregulloreje sigurohet nga rektori i Kolegjit Universitar “Bedër”.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë	Senati